



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

#### *Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë*

### PROCESVERBAL

Tiranë, më 26.01.2022, ora 12:00

#### **Drejton mbledhjen:**

**Albana Vokshi – kryetare e Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 09.11.2021, 10.11.2021, 11.11.2021, 18.11.2021, 22.11.2021 dhe 07.12.2021.
2. Miratimi i kalendarit të punës së komisionit për periudhën 17 janar – 4 shkurt 2022.
3. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e konventës 190 “Konventa për dhunën dhe ngacmimin” të Organizatës Ndërkombëtare të Punës 1986”.

#### **Marrin pjesë:**

Albana Vokshi, Klodiana Spahiu, Dasantila Tahiraj, Florenc Spaho, Niko Kuri, Shpresa Marnoj, Mirela Pitushi, Tatiana Piro, Lindita Buxheli, Ilir Metaj, Gertjan Deda, Petrit Vasili, Orjola Pampuri dhe Ismet Beqiraj.

#### **Mungojnë:**

Ilirian Pendavinji, Anila Denaj, Grida Duma, Mesila Doda, Tritan Shehu, Zheni Gjergji, Ilda Dhori dhe Seladin Jakupllari.

#### **Të ftuar:**

Merita Xhafaj Drejtoreshë e Përgjithshme e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Olta Manjani – Zëvendësministre e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Luljeta Krasta – Përgjegjëse e Sektorit në Sektorin e Marrëdhënieve të Punës dhe Dialogut Social

Genta Prodani – Përgjegjëse në Sektorin e Politikave të Punësimit dhe Migrator

## HAPET MBLEDHJA

**Albana Vokshi** – Mirëdita!

*(Mungesë incizimi)*

...si t'ju bjerë për mbarë, sepse është ftohtë, ose 31, 1, 2, kur ta keni ju për mbarë, caktojani. Nëse keni mbledhje grupi, do ta lëmë ditën e hënë pas mbledhjes së grupit. Dakord? Po.

Shtoni çështjet që doni të trajtojmë.

Klodiana, cilat janë çështjet që do të diskutojmë? Kanceri i qafës së mitrës, kujdesi paliativ?

Zoti Vasili, ke ndonjë shtesë?

Keni thirrur edhe shoqatat, patjetër, të gjitha palët e interesit, edhe pacientët, shoqatën e pacientëve *“Together for life”*.

Atëherë, ta mbyllim kalendarin e komisionit.

Konventa që do të shqyrtojmë sot, është për seancën plenare të datës 3 shkurt, prajemi në kohë. Vendosëm që ose ditën e hënë, ose të martën do të zhvillojmë një seancë dëgjimore me ministrinë dhe me shoqatat për kujdesin paliativ, për kancerin e qafës së mitrës. Meqenëse në datën 4 shkurt është dita ndërkombëtare, a keni ndonjë propozim tjetër? Kalendarin mbyllet në datën 4 shkurt dhe nga data 4 shkurt fillon kalendarin tjetër 3-javor. Nuk keni.

E mbyllim pjesën e parë të mbledhjes.

Kalojmë te miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të kaluara, procesverbalet ju janë dërguar. Janë mbledhjet e zhvilluara në datat 9, 10, 11, 18, 22 nëntor dhe 7 dhjetor. Keni ndonjë vërejtje? Jeni dakord.

Miratohen.

Kalojmë te projektligji “Për ratifikimin e konventës 190 “Konventa për dhunën dhe ngacmimin” të Organizatës Ndërkombëtare të Punës 1986”.

Nga Ministria e Ekonomisë kemi të ftuar: zonjën Olta Manjani, zëvendësministre e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, zonjën Luljeta Krasta, përgjegjëse e Sektorit në Sektorin e Marrëdhënieve të Punës dhe Dialogut Social, si dhe zonjën Genta Prodani, përgjegjëse e Sektorit në Sektorin e Politikave të Punësimit dhe Migratore. Nga Ministria e Shëndetësisë është prezente zonja Merita Xhafaj, drejtoreshë e Përgjithshme e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Zonja Xhafaj ka dërguar sot në mëngjes një *e-mail*, ku sqaron se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk është bashkëpropozuese me

Ministrinë e Financave për këtë projektligj. Zonja Xhafaj ka shkruar se nuk kanë asnjë material nga Ministria e Financave për këtë projektligj.

Në projektligj si agjenci zbatuese është edhe ministria juaj. Pra, unë nuk e kuptoj fare *e-mailin* tuaj, pra sesi një institucion përgjegjës për zbatimin e konventës të mos ketë asnjë informacion dhe të mos jetë dakordësuar parimisht për këtë projektligj, të cilin do ta miratojmë sot. Jeni agjenci zbatuese direkte.

**Merita Xhafaj** – Faleminderit, zonja Kryetare, për pyetjen!

Ne nuk jemi agjenci, por institucioni, ministria e linjës, kemi dhënë dakordësinë, sikurse edhe është kërkuar dhe kërkohet në bazë të teknikës legislative nga të gjitha institucionet dhe ministritë e linjës.

Së dyti, duhet ta lexoni të plotë *e-mailin* që kam dërguar, sepse aty kam thënë se ne kemi dhënë mendimin si ministri linje.

**Albana Vokshi** – Më fal! Kur thoni se nuk keni asnjë dokument, si e kuptoni? Çfarë mendimi keni dhënë, kur nuk keni asnjë dokument? Bini në kontradiktë me veten tuaj.

**Merita Xhafaj** – Me atë që kam shkruar, nuk bie në kontradiktë; kam shkuara në sistemin “*e-akte*”. Materiali është i hedhur direkt në sistemin “*e-akte*”, nuk ka ardhur në *hard copy* tek ne dhe në sistemin “*e-akte*”, duke qenë se ne e njohim konventën, normalisht se nuk është sot, konventat e ILO-s trajtohen gjithmonë në marrëdhëniet punëdhënës-punëmarrës. Është ky raporti dhe kjo është arsyeja. Megjithatë, nuk kam ndonjë kundërshtim, sepse ne kemi dhënë dakordësinë. Unë kam shkruar atë që kam shkruar për faktin se jam thirrur si përfaqësuese e institucionit, si dhe për faktin që në relacion është shkruar: “Zbatuese Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”, kur ju e dini shumë mirë se, bazuar në teknikën legislative, të gjitha konventat raportohen nga Ministria e Jashtme, në të gjitha konventat është palë koordinuese Ministria e Jashtme. Në rastin konkret mund të ketë shumë ministri që përfshihen aty brenda, por kjo nuk do të thotë që kanë detyrimin për të përfaqësuar dhe për të mbrojtur në komision një akt që nuk e kanë propozuar apo bashkëpropozuar, sikurse është ndjekur kjo praktikë nga ju. Për korrektesë unë jam këtu.

**Albana Vokshi** – Ju falënderoj që keni ardhur për korrektesë këtu dhe duhet të jeni këtu, sepse jeni agjenci zbatuese dhe në raportin e projektligjit, pika 7 “Institucionet dhe organet që ngarkohen për zbatimin e aktit” thuhet: “Për zbatimin e këtij akti ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe institucionet e tjera të angazhuara në fushën e luftës kundër dhunës dhe ngacmimit në mjedisin e punës, duke përfshirë këtu organizatat e punëdhënësve dhe punëmarrësve”. Pra,

nëse ligji ju ngarkon me përgjegjësi direkte për zbatimin, duhej të ishit pjesë aktive. Gjithsesi, ju falënderoj që jeni këtu!

Ia kaloj fjalën zëvendësministres së Financave për të shpjeguar arsyen pse është sjellë ky projektligj tani, si dhe një pamje të situatës së dhunës dhe ngacmimit në mjediset e punës.

**Olta Manjani** – Faleminderit!

E nderuar zonja Kryetare e komisionit,

Të nderuar deputetë,

Ministria e Financave dhe Ekonomisë kanë ndërmarrë iniciativën për ratifikimin e konventës nr. 190 të ILO-s për eliminimin e dhunës dhe ngacmimit në vendin e punës, në bashkëpunim me Konfederatën Sindikale dhe Bashkimin e Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë.

Ratifikimi i kësaj konvente ka për qëllim pozicionimin e vendit tonë në grupin e vendeve që kontribuojnë në luftën kundër fenomenit shqetësues dhe kërcënues për dinjitetin, shëndetin dhe sigurinë në punë, si dhe për garantimin e një modeli pune të sigurt. Në sesionin e 108-të të Konferencës vjetore të Organizatës Ndërkombëtare të Punës për 100-vjetorin e themelimit të kësaj organizate në datën 21 qershor të vitit 2019 është miratuar konventa nr. 190, e cila ka në fokus eliminimin e dhunës dhe ngacmimeve me bazë gjinore në vendin e punës.

Ratifikimi i kësaj konvente është në përputhje me programin e qeverisë shqiptare, e shprehur qartazi në të gjitha instrumentet që gjenden në kuadrin ligjor dhe institucional shqiptar. Ky proces ka avantazhet e tij dhe deri tani vendi ynë ka bërë një përparim të konsiderueshëm. Shumë ligje janë në përputhje me standardet e BE-së, si Kodi i Punës, ligji “Për barazinë gjinore”, ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ligji “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, ligji “Për arsimin dhe formimin profesional” e të tjerë. Një numër i konsiderueshëm i konventave ndërkombëtare, që janë të rëndësishme në kontekstin e analizës së konventës nr. 190 të ILO-s janë ratifikuar tashmë. Kjo e bën edhe më të lehtë përqasjen ndaj kësaj konvente.

Ky projektligj është dërguar për mendim në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme, e cila na kërkoi të bëhej një studim nëse legjislacioni ynë i brendshëm është në përputhje me parashikimet e kësaj konvente. Për këtë arsye, meqenëse Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk i kishte kapacitetet e duhura për ta bërë këtë studim, iu drejtuaam Zyrës Ndërkombëtare të Punës të ILO-s, e cila kontrakttoi një eksperte të fushës për të bërë një analizë më të detajuar të legjislacionit shqiptar mbi dhunën dhe ngacmimin në punë, si dhe përputhshmërinë e saj me konventën nr. 190. Nga analiza ka

rezultuar se legjislacioni ynë i plotëson kërkesat minimale të konventës, gjë që na mundëson vazhdimin e procedurës, duke programuar përmirësimin e legjislacionit në vijimësi, sa herë që bëhen ndryshime në legjislacion për të trajnuar strukturat që janë në dispozicion. Zbatimi i kësaj konvente nuk kushtëzohet nga dalja e menjëhershme e ligjeve, sepse nuk janë ligje të reja, nuk kërkon struktura të reja, por nevojiten saktësime procedurale dhe përcaktim të qarta të detyrave në të ardhmen.

Konventa nr. 190 e ILO-s për eliminimin e dhunës dhe ngacmimin në botën e punës u miratua në parim nga përfaqësuesit e punëdhënësve dhe sindikatat në mbledhjen e datës 12 qershor të vitit 2020 të Këshillit Kombëtar të Punës. Më pas u miratua në parim edhe analiza e legjislacionit shqiptar mbi dhunën dhe ngacmimin në punë kundrejt përputhshmërisë me konventën nr. 190 të ILO-s në mbledhjen e KKP-së të datës 16 tetor 2020. Ratifikimi i kësaj konvente do të sjellë zbatimin efektiv të dispozitave ligjore duke promovuar programet sensibilizuese, arsimore dhe bashkëpunim me partnerët socialë për kauzën e sigurimit të një mjedisi jo të dhunshëm dhe të ngacmimeve në marrëdhëniet e punës.

Bazuar edhe në statistikat e Inspektoratit të Punës deri tani nuk ka pasur raste të raportuara për ngacmimin apo dhunë në vendin e punës.

**Albana Vokshi** – Faleminderit!

Ia kaloj fjalën relatores.

**Mirela Pitushi** – Të nderuar kolegë,

Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e konventës 190 “Konventa për dhunën dhe ngacmimin” të Organizatës Ndërkombëtare të Punës 1986” është një hap më tej në legjislacionin shqiptar për eliminimin e dhunës dhe të ngacmimit në vendin e punës. Përfaqësues të qeverisë shqiptare e kanë mbështetur dhe e kanë votuar pro këtë konvente në organizmat ndërkombëtarë. Nga të punësuarit në botën e biznesit në sektorin privat, por dhe në atë shtetëror janë përcjellë jo një herë sinjale të dhunës dhe të ngacmimit të shumëllojshëm, që kanë shkaktuar probleme serioze për shëndetin e të punësuarve, pavarësisht gjinisë dhe moshës së tyre. Qeveria shqiptare përmes marrëveshjes dhe ligjeve ka frenuar dhe i ka minimizuar këto probleme. Mbetet ende shumë për t’u bërë për rritjen e ndërgjegjësimin dhe të reagimit të vetë qytetarëve, që përballen me këto fenomene për t’u çliruar nga këto dukuri. Mbrojtja ligjore që ofrohet nëpërmjet kësaj konvente, të cilën e diskutojmë, është shenjë pozitive për krijimin e një mjedisi sa më të qetë dhe të pastër në vendin e punës. Problematika e trajtuar nga kjo konventë është ajo e fenomenit të dhunës dhe ngacmimit në punë, e cila përbën kërcënim për sigurinë e shëndetit publik. Një ndër efektet e

prishme për ratifikimin e kësaj konvente është përmirësimi institucional, social ekonomik, si dhe kuadri ligjor në këtë fushë.

Në kuadër edhe të ecurisë së vendit tonë drejt integritit europian, është një domosdoshmëri intensifikimi i luftës kundër diskriminimit dhe dhunës me bazë gjinore në fushën e marrëdhënieve të punës, që janë fenomene kërcënuese për dinjitetin, sigurinë dhe shëndetin publik. Kjo konventë shpjegon qartë të drejtën e secilit për një mjedis pune të lirë nga dhuna e nga ngacmimi, duke identifikuar edhe sjelljet që mund të përbëjnë shkelje ose abuzim të të drejtave të njeriut. Vlera e kësaj konvente qëndron edhe në faktin se kjo është një marrëveshje ndërkombëtare në mbrojtje të së drejtës së çdonjërit për një botë pune të lirë nga dhuna dhe ngacmimi, duke identifikuar edhe sjelljet që mund të përbëjnë shkelje ose abuzim të të drejtave të njeriut. Objektivat që synohen të arrihen me ratifikimin e kësaj konventa janë forcimi dhe plotësimi i kuadrit ligjor ekzistues, krijimi i hapësirave në zbatimin e parimit të kësaj konvente, duke përmirësuar legjislacionin kombëtar për afrimin me standardet ndërkombëtare të punës së ILO-s.

Një numër i konsiderueshëm i konventave ndërkombëtare që janë të rëndësishme në kontekstin e analizës së konventës 190 të ILO-s, janë ratifikuar tashmë, dhe kjo e bën edhe më të lehtë përqasjen me këtë konventë. Teksa Shqipëria aspirojnë të anëtarësohet në Bashkimin Europian arritja e standardeve në barazi dhe mosdiskriminim është një kusht për integrimin e mëtejshëm në këtë organizatë, sepse është detyrë e një vendi si Shqipëria të harmonizojë legjislacionin e saj me atë të Bashkimit Europian.

Ratifikimi i kësaj konvente dhe projektligji janë në përputhje me programin e qeverisë shqiptare, e shprehur kjo në të gjitha instrumentet që gjenden në kuadrin ligjor e institucional shqiptar. Procesi ka avantazhet e veta dhe deri tani vendi ynë ka bërë një përparim të konsiderueshëm. Shumë ligje janë në përputhje me standardet e Bashkimit Europian të tilla si Kodi i Punës, ligji për barazinë gjinore, ligji për mbrojtjen nga diskriminimi dhe ligji për sigurinë dhe shëndetin në punë.

Konventa nuk parashikon shpenzime buxhetore konkrete. Legjislacioni plotëson kërkesat minimale të konventës, çka na mundëson vazhdimin e procedurës, duke programuar përmirësimin e legjislacionit në vijim duke bërë ndryshime në legjislacion dhe në trajtimin e strukturës në dispozicion. Zbatimi i kësaj konvente nuk kushtëzohet nga dalja e menjëhershme e ligjeve, sepse nuk është terren ligjor i ri dhe nuk kërkohen struktura të reja, gjithsesi nevojiten saktësime procedurale dhe përcaktime të qarta detyrash. Konventa hyn në fuqi për çdo anëtar 12 muaj pas datës kur është regjistruar ratifikimi i saj. Çdo anëtar që ratifikon këtë konventë respekton, promovon dhe realizon të drejtën e gjithsecilit për një botë

pune pa dhunë dhe ngacmime. Çdo anëtar miraton në përputhje me legjislacionin kombëtar edhe rrethanat dhe në konsultim me organizatat e punëdhënësve dhe të punëtorëve përfaqësues, një qasje gjithëpërfshirëse të integruar dhe me përgjegjësi gjinore për parandalimin, eliminimin e dhunës dhe ngacmimin në botën e punës, duke pasur një përfaqje të legjislacionit të vendit tonë me ato të vendeve të Bashkimit Europian në raport me dhunën, ngacmimin dhe diskriminimin me bazë gjinore në fushën e marrëdhënieve të punës dhe punësimit do të jenë më efikase rezultatet e këtij procesi, ndryshimi i materialeve të punës, të kushteve dhe të vendit të punës, duke i parë me syrin dhe mentalitetin e një mjedisi familjar.

Të nderuar kolegë,

Duke shqyrtuar brendësinë e kësaj konvente dhe përfitimet e gjithanshme jam e bindur që ratifikimi i kësaj konvente do të sjellë mundësinë që praktikat dhe dispozitat diskriminuese të zvogëlohen e shfuqizohen më shpejtë dhe autoritetet do të kenë interes të marrin përvojë pozitive nga vendet e tjera si një shembull frymëzues.

Unë shpreh bindjen që përmes miratimit dhe diskutimit të projektligjit për “Për ratifikimin e konventës 190”, Konventa për Dhunën dhe Ngacmimin të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, 1986, dhe miratimin më pas të këtij projektligji hedhim edhe një hap më tej në drejtim të mbrojtjes së të drejtës së çdo njeriu të punësuar për të pasur qartësinë e tij morale, shpirtërore dhe fizike gjatë kohës së ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

Ju faleminderit!

**Albana Vokshi** – Faleminderit, Mirela!

A ka pyetje? Po, Klodi.

**Klodiana Spahiu** – Përshëndetje!

Falënderoj zëvendësministren dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Financave dhe të Ministrisë së Shëndetësisë që janë sot të pranishëm!

Unë do ta konsideroja shumë të rëndësishme këtë konventë, sepse ashtu edhe siç është shkruar në relacion, është e barabartë me rëndësinë që ka pasur Konventa e SIDO-s apo Konventa e Këshillit të Europës, pasi janë të njëjlojta. Megjithatë, uroj dhe shpresoj që të gjitha ato udhëzime ose direktiva që janë dhënë në këtë konventë të jenë të realizuara sa më shpejt!

Ne si komision kemi kaluar shumë ligje, siç kanë qenë ndryshimet e rëndësishme që i janë bërë Kodit të Punës në vitin 2015, gjithmonë në mbështetje të të drejtave të punëmarrësve, duke i bërë të gjithë bashkë, maxhorancë dhe opozitë, dhe kanë qenë me shumë vlerë ndryshimet që i kemi bërë ligjit për barazinë gjinore, ligjit për shëndetin dhe sigurinë në punë dhe ligjit mbrojtjen nga diskriminimi e të tjera.

Ju thatë që bazën ligjore minimaliste e kemi për këtë konventë dhe tashmë të gjitha udhëzimet janë dhënë, duke u nisur edhe nga mbledhja e dy Këshillave Kombëtarë, prandaj do të doja një informacion pak më të zgjeruar nga zëvendësministrja dhe drejtoresha e Zyrës së Punës dhe Emigracionit në lidhje me këto dy takime që janë bërë. Ne jemi komision për dhënie mendimi dhe nuk kemi mundësi të bëjmë seanca dëgjimore, prandaj do të doja të dija, cilat kanë qenë ankesat e tyre?

Ju deklaruar se nga Inspektorati i Punës deri tani nuk ka pasur ankesa, megjithatë një informacion më i detajuar do të ishte i domosdoshëm për Komisionin e Shëndetësisë, të paktën sa u takon dy takime që janë bërë me Këshillin Kombëtar të Punës.

**Luljeta Krasta** – Më falni se nuk e dëgjova pyetjen!

**Albana Vokshi** – Ju lutem, më shumë vëmendje kur ju bëjnë pyetje!

**Klodiana Spahiu** – Një informacion më të detajuar në lidhje me dy takimet që janë bërë në Këshillin Kombëtar të Punës dhe cilat kanë qenë disa nga propozimet që ata kanë bërë ose çfarë plani pune keni hartuar ju për fillimin e këtyre ndryshimeve në të gjitha ligjet që u përmendën?

Unë besoj se këtu janë shumë ministri dhe do të jetë një ndërbashkëveprim ndërministrorë për t'i realizuar të gjitha këto ndryshime.

**Luljeta Krasta** – Ashtu siç jua tha edhe zëvendësministrja, në mbledhjen e Këshillit Kombëtar të Punës është miratuar në parim konventa. Në këtë takim nuk u mor ndonjë masë konkrete, pasi u la që me ratifikimin e konventës më pas të mblidheshin partnerët socialë dhe të vendosnin ose të bënin një plan veprimi se ku duhej të ndërhyenin për përmirësimin e legjislacionit apo hartimin e projektvendimeve përkatëse lidhur me këtë çështje.

Gjithashtu, është bërë një studim goxha i detajuar nga ana e profesoreshës së nderuar, Arta Mandro, të cilin mund t'jua vëmë në dispozicion, ku është bërë një analizë e detajuar sa i takon legjislacionit në këtë fushë. Konkretisht nuk kemi ndonjë plan veprimi për masat që do të merren në të ardhmen.

**Olta Manjani** – Më falni, kisha diçka!

Nga momenti i ratifikimit dhe deri në hyrjen në fuqi ne do ta vlerësojmë të gjithë, duke u bazuar edhe në studimin e profesoreshës Arta Mandro, legjislacionin dhe procedurat administrative qoftë edhe ato të Inspektoratit të Punës për ta kontrolluar situatën.

**Klodiana Spahiu** – A mundem, zonja kryetare?

**Albana Vokshi** – Po.

**Klodiana Spahiu** – Nëse do të jetë e mundur, do të ishte e domosdoshme që ne ta kishim këtë studim në komisionin tonë, njëkohësisht edhe raportin e mbledhjeve të Këshillit



Kombëtar, sepse për ne janë shumë të rëndësishme ndryshimet që do të bëhen. Unë besoj se ky është një hap shumë i rëndësishëm për integrimin e Shqipërisë në BE, jo vetëm për ILO-n.

Faleminderit!

**Olta Manjani** – Do t'jua vëmë të gjithë materialin në dispozicion brenda ditës së sotme.

**Albana Vokshi** – Faleminderit!

Kam edhe unë disa çështje për të ngritur, së bashku me pyetjet.

Ju thatë që nuk është raportuar asnjë rast diskriminimi në ambientet e punës nga Inspektorati i Punës...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

...dhune dhe diskriminimi, sepse këtë po shqyrtojmë sot.

Ju mendoni që në të gjitha ambientet e punës nuk ka dhunë dhe diskriminim apo Inspektorati i Punës nuk po e bën ashtu siç duhet punën dhe rolin e tij?

Të thuash që nuk ka dhunë dhe diskriminim është absurde, madje të vini edhe në një komision parlamentar dhe të thoni që nuk është raportuar, do të thotë që ose ju nuk i kërkonit llogari Inspektoratit të Punës ose nuk e keni konsideruar këtë çështje ashtu siç duhet për rëndësinë që ka.

Po i referohem situatës që ka reflektuar qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim dhe Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, të cilët kanë bërë një sondazh dhe pas sondazhit kanë bërë edhe një raport, ku evidentohet që situata e ngacmimit dhe e dhunimit në ambientet e punës është e rënduar, pra është një fenomen që shihet kudo.

Pra, nëse ka një studim që është financuar nga Bashkimi Europian dhe qeveria suedeze, janë para të taksapaguesve europianë që janë harxhuar për të bërë një studim për ngacmimin dhe dhunën në ambientet e punës dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave nuk e paska të qartë situatën e rënduar në ambientet e punës, kjo nuk shkon. Sipas raportit të këtij studimi, ku janë pyetur 1087 të anketuar, këtë duhej ta kishit ditur zonja zëvendësministre, drejtoresha dhe drejtoreshat e tjera, para se të vinit këtu, pra pyetjen: nëse diskriminimi i dikujt në punë për shkak se ishte grua apo burrë është i paligjshëm. 75% e kanë konsideruar të paligjshëm, nga gratë 74% e kanë konsideruar të paligjshëm, 62% e burrave të paligjshëm, 11% nuk mendojnë se është i paligjshëm, 14%, ku 13% e grave dhe 28% e burrave nuk e dinë fare se çfarë është.

Në një raport tjetër, ku janë pyetur se në cilin institucion duhet të raportohet diskriminimi, 40% e grave dhe 45% e burrave mendojnë se duhet raportuar te vetë punëdhënësi dhe nuk e dinë që kishte edhe Komisioner për Diskriminimin, Avokat të

Popullit e të tjera. Është fare e qartë nga përqindjet për të cilat janë përgjigjur të anketuarit, se 22% e burrave mendojnë që diskriminimi në punë duhet denoncuar në polici dhe 12% nga gratë. Avokati i Popullit është evidentuar nga 16% e grave, 10% e meshkujve dhe që nuk e dinin 26% e burrave dhe 22% e grave.

Unë mendoj, kështu mund të vazhdoj edhe me pikat e tjera të studimit të të anketuarve, se ankuesit që e kanë përjetuar diskriminimin me bazë gjinore në punë 97% e grave dhe 100% e meshkujve nuk e kanë raportuar në asnjë institucion. Çfarë do të thotë kjo? Kjo do të thotë që ju vini me një konventë sot dhe na thoni që do ta marrim studimin e studiueses dhe do ta ratifikojmë, por pa paketë ligjore bashkëngjitur, ndërkohë që radha e punës duhet të jetë krejt e kundërta. Ratifikimi i sotëm duhej të kishte ardhur me paketë ligjore bashkëngjitur, me një plan pune konkret bashkëngjitur, me institucionet ligjzbatuese bashkëngjitur dhe së bashku me buxhetin, sepse ne duhet ta dimë paraprakisht se si është.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Më falni, unë di atë që sapo tha zëvendësministrja, që nuk i kemi. Tani ose ju i dini dhe nuk i keni sjellë ose nuk ia keni raportuar institucionit përgjegjës?

Të lutem, mos më ndërhyini!

Po i referohem asaj që zëvendësministrja sapo tha, pra që pas ratifikimit do të ulemi dhe do t'i shohim se për cilat ndryshime ligjore ka nevojë. Për planin e punës tha se nuk e kemi dhe do ta bëjmë, ndërkohë që si paketë duhet të kishte ardhur, sepse ne kur miratojmë një konventë, duhet ta kemi parasysh se çfarë duhet në mënyrë që ta mbështesim apo nuk është kështu?

Pra, ta mbështesim dhe të dimë se cili është plani dhe kalendari i projektligjeve që do të vijnë në këtë komision dhe cili është buxheti i nevojshëm që edhe ne të ndihmojmë nëse ka nevojë te ministria përkatëse për të buxhetuar çdo hap dhe për të krijuar një ambient më të shëndetshëm në mjediset e punës. Por, kur 97% e grave dhe 100% e totalit nuk e raportojnë, do të thotë që këtu nuk funksionon absolutisht asgjë, as sensibilizimi ndaj grave dhe burrave në ambientet e punës, as punëdhënësi nuk kontrollohet dhe këtë e kam nga raportet që janë financuar nga BE-ja dhe nga qeveria suedeze.

Në vitin 2021 janë marrë 229 vendime nga Komisioneri kundër Diskriminimit në vendin e punës, ndërsa zonja zëvendësministre sapo tha që nuk është raportuar asnjë rast diskriminimi, në vitin 2020 janë marrë 155 vendime, ndërsa për vitin 2022 janë marrë 5 vendime, pra nuk është rozë. Njerëzit nuk kanë besim prapë tek institucionet dhe informimi i saktë tek institucionet ku drejtohet personi, i cili është diskriminuar në vendin e punës mungon. Këto janë çështje që duhen trajtuar me shumë prioritet dhe punëdhënësit nuk mund

të lihen të bëjnë atë që duan me punëmarrësit, këtu është garancia që duhet të japë shteti në bazë të konventave që ne sot i miratojmë, por nesër nuk zbatohen, sepse problemi kryesor është zbatimi i konventave dhe i ligjeve që miratohen dhe jo se nuk kemi konventa apo bazën ligjore të duhur.

Edhe një herë, ndoshta zonja Xhafaj mund të na sqarojë pak më shumë, meqenëse keni disa vite që e keni ndjekur si problematikë, sepse në këndvështrimin tim gabimi më i madh që është bërë është shkrirja e Ministrisë së Punës që u krijua në vitin 1992 dhe më pas kaloi nga një ministri në një ministri tjetër, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ndjek çështjet e punësimit, ministria juaj të çështjeve sociale. Për mua kjo është diçka që e ka shtuar problematikën në këtë sektor.

Në faqen numër 2 të relacionit ju thoni: kjo konventë do të rrisë përgjegjësinë më të lartë në adresimin e fenomenit të dhunës e të ngacmimit në botën e punës dhe njëherazi nivelin e përqasjes së legjislacionit vendas me standardet e ILO-s dhe me ato të vendeve të Bashkimit European në raport me dhunën, ngacmimin, diskriminimin me bazë gjinore në fushën e marrëdhënieve të punës dhe të punësimit.

Pra, zakonisht vendet punojnë duke përgatitur legjislacionin përkatës dhe më pas e ratifikojnë. Ju lutem, a keni ju dijeni se cilat janë ndryshimet që duhet të bëhen në Kodin e Punës? Cilat janë ndryshimet që duhen bërë, apo ju mendoni që duhen bërë në ligjet e tjera që pritet të vijnë në këtë komision?

Po ashtu, në faqen 2 të relacionit thuhet: “Me ratifikimin e kësaj konvente shtetet kanë hapësira në zbatimin e parimeve të saj nga strukturat përkatëse, të cilat monitorojnë, inspektojnë në përmbushjen e detyrimeve, në reduktimin e eliminimit të dhunës, ngacmimit në punë dhe sigurojnë ndërgjegjësimin dhe mbrojtjen e duhur të viktimave dhe të organizatave respektive të punëdhënësve dhe punëmarrësve”.

Siç u evidentua këtu e kemi zero nivelin e ndërgjegjësimin.

Pra, edhe një herë dua t’ju pyes: cilat janë institucionet që ju mendoni se duhet të jenë direkt përgjegjëse, përveç jush? Si mendoni ju ta rrisni ndërgjegjësimin për denoncimin, raportimin e më shumë rasteve të dhunës dhe të ngacmimit në vendet e punës? A mendoni ju se duhet të ketë institucione të reja bazuar edhe në modelet e vendeve të rajonit apo në modelet e vendeve të Bashkimit European? A do të ketë shtesë kompetence në ministrinë tuaj apo në Ministrinë e Ekonomisë dhe këto shtesa, nëse do të ketë, sa do të kushtojnë? A do të kenë punëdhënësit shtesë kërkesë për një mjedis më të sigurtë për punëmarrësit?

Edhe unë i bashkohem kërkesës së zonjës Spahiu, prandaj do t’ju lutesha që brenda ditës, nëse është e mundur, të na dërgoni raportin e Këshillit Kombëtar të Punësimit së

bashku me studimin që ju sapo përmendët, për të pasur një ide më të mirë para se të shkojmë për ta miratuar në seancë plenare.

Në faqen 5 të relacionit thuhet: “Legjislacioni plotëson kërkesat minimale të konventës, çka na mundëson vazhdimin e procedurës duke programuar përmirësimin e legjislacionit në vijimësi sa herë bëhen ndryshime në legjislacion dhe trajnuar strukturat në dispozicion. Këtu bëhet fjalë për Kodin e Punës, kontratat kolektive e të tjera, ndërsa politikat dhe rregulloret janë pjesa që kanë nevojë për t’u azhornuar pjesërisht në disa aspekte të kësaj konvente”.

Cili është programi i përmirësimit dhe i ndryshimit në legjislacion apo për trajtimin e strukturave?

Po ashtu, në faqen 5, kjo është e fundit që dua të ngre, thuhet: “Zbatimi i kësaj konvente nuk kushtëzohet nga dalja e menjëhershme e ligjeve, sepse nuk është terren ligjor i ri dhe nuk kërkohen struktura të reja, gjithsesi nevojiten saktësime procedurale dhe përcaktime të qarta detyrash”.

Meqenëse nuk është terren i ri ligjor dhe nuk kërkohen struktura të reja, pse të mos e shtyjmë pak derisa ju të keni një paketë ligjore të saktë bashkëngjitur kësaj konvente dhe ta miratojmë si një paketë normale ashtu siç duhet të vijë normalisht në komision?

**Merita Xhafaj** – Shumë faleminderit, zonja kryetare!

I gjej me vend të gjitha komentet tuaja. Në fakt, do të doja t’ju sillja në vëmendje që zëvendësministrja është e re, ka një fëmijë 40-ditësh dhe duhet t’i japim kohën për t’u përgjigjur, sepse kjo kërkon eksperiencë dhe njohjen e të gjithë dokumentacionit, por natyrisht ekipi që e shoqëron ka një eksperiencë shumë të gjatë në punë, qoftë zonja Prodani apo zonja Krasta.

Ajo që është shpjeguar në këtë relacion është fakti që ka disa konventa, të cilat kanë një lidhje me njëra-tjetrën, pikërisht Konventa SIDO dhe konventa e Stambollit, të cilat, t’ju them të drejtën, gjej rastin këtu t’ju informoj, se Shqipëria nga 19 rekomandimet urgjente të GREVIO-s u gjet një nga vendet që ka realizuar me sukses dhe ka zbatuar të 19 rekomandimet, por kjo ndoshta do të raportohet në një moment të caktuar në një mbledhje të Nënkomitetit për Barazinë Gjinore. Pra, ka disa konventa, të cilat kushtëzojnë ndryshimet ligjore.

Në analizën që ka përgatitur Ministria e Financave përfshihet qoftë analiza e Kodit të Punës, qoftë legjislacioni tjetër. Ligji më i vjetër që ka nevojë për rishikim është ligji “Për barazinë gjinore”, sepse ne kemi bërë ndryshimet respektive qoftë në Kodin Penal, qoftë në ligjin “Për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare”, që i kemi kaluar së bashku. Këto

janë bërë nisur nga rastet që thatë, por nuk janë bazuar domosdoshmërisht në këtë konventë, sepse nuk ka qenë konventë e miratuar.

Arsyeja pse unë mendoj se është e domosdoshme që ta kaloni është, sepse analiza ligjore shpreh shumë qartë qoftë terminologjinë, qoftë përkufizimet e përdorura në Kodin e Punës, po kështu edhe në gjithë legjislacionin tjetër, që është në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Nga ana tjetër, ka disa struktura, unë ju informoj që në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me ndryshimin e organigramës që është bërë në fund të dhjetorit, Sektori i Barazisë Gjinore është ndarë si një sektor më vete dhe nuk është më sektor së bashku me përfshirjen sociale, sikurse ka qenë më parë. Struktura apo kosto financiare shtesë për zbatimin e kësaj konvente nuk do të ketë, sepse në qoftë se do të ketë një apo dy ndryshime të vogla në legjislacionin shqiptar, ato do të zbatohen nga të njëjtat struktura dhe nuk besoj se ka nevojë për struktura shtesë.

Cilat janë institucionet për zbatim?

Mendoj se një rol të veçantë e ka Ministria e Brendshme krahas Ministrisë së Financave. Ne nuk jemi ekzekutues, sepse nuk është bërë me bashkëpropozim (do të ishte një rrugë shumë e mirë), por, nga ana tjetër, Ministria e Drejtësisë ka rolin e vet në ekzekutimin dhe zbatimin e kësaj konvente; Ministria e Arsimit po ashtu ka rolin e vet në zbatimin e kësaj konvente, pa folur këtu për punëdhënësin dhe punëmarrësin. Për shkak se të gjithë janë përfaqësues të Këshillit Kombëtar të Punës, mendoj se është ezauruar që të gjitha institucionet që kanë përfaqësim në këtë këshill, janë institucione, të cilat janë të detyrueshme për zbatim.

Do të doja të sillja në vëmendje edhe diçka tjetër. Bazuar në *aqui* për efekt të vlerësimit që bëhet, apo të *screening* që bëhet për shkak të plotësimit të *aqui*-ve, si pasojë e ambicies sonë për të qenë pjesë e BE-së, është lidhur një marrëveshje ndërmjet sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës dhe sekretarit të Përgjithshëm të BE-së dhe ne në raportime marrim në konsideratë Konventën e Stambollit. Pra, për efekt të dhunës konsiderohet kjo, dhe jo konventa e ILO-s. Për këto arsye janë bërë edhe ndryshimet ligjore respektive edhe në legjislacionin shqiptar për t'i përputhur me *aqui*-të. Pra, ne nuk kemi një ndërhyrje madhore që të mund të paraqitej një plan këtu, por mendoj se ai studim është i mjaftueshëm. Mund të plotësoj edhe materialin e relatores, ndjesë që e them këtë, por edhe për shkak të ekspertizës në këtë fushë, e gjykoj me vend që komisioni të marrë një vendim për ta miratuar këtë konventë sot, sepse nuk ka detyrime ekstra dhe shtesë.

Nga ana tjetër, si përfaqësuese e Ministrisë së Shëndetësisë, nisur edhe nga studimet që janë bërë nga organizatat tona partnere si Aleanca për Barazi Gjinore, IDM-ja apo edhe organizata të tjera, të cilat bëjnë studime me financime në kuadër të marrëveshjeve të qeverisë shqiptare me donatorë të tjerë, kanë qenë shumë ndihmë për ne. Përtej kësaj, ka pasur raste të diskriminimit në vendin e punës të grave, të cilat kanë vuajtur procesin e trajtimit pas ndërhyrjes për pasojë të kancerit të gjirit apo raste të tilla, të cilat kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë në vëmendjen tonë.

Unë mund t'ju sjell raportet e fundit që kemi përgatitur dhe këto do të jenë një nga dokumentet që mund t'i bashkëngjisni në dosjen respektive për kalimin e kësaj konvente.

Gjithsesi, shpreh vullnetin dhe angazhimin e Ministrisë së Shëndetësisë për zbatimin e të gjitha detyrimeve të kësaj konvente. Faleminderit!

**Ilir Metaj** – Duke qenë se jemi duke diskutuar miratimin e një konvente shumë të rëndësishme, na takon që të jemi të saktë në ato që themi dhe t'i themi gjërat hapur, ashtu siç janë.

Dua të mbështes kryetaren kur thotë se nuk është e drejtë kur ju thoni se nuk është rast ngacmimi apo dhune, sepse, të paktën së fundi ne jemi bërë lajm i keq botëror pikërisht në këtë drejtim, për fat të keq, kur më 8 mars patëm një rast masiv dhe drastik të ushtrimit të dhunës dhe të ngacmimit në ambientet e punës, që ndodhi pikërisht në ditën me diell. Kështu që, pyetja ime është: a keni një paketë ligjesh apo qoftë edhe iniciativa të marra për të rritur standardet e kapitalit human, që shfaqje të shëmtuara si ajo e 8 marsit të mos ndodhin më, në mënyrë që Shqipëria të mos bëhet më lajm i keq? Faleminderit!

**Klodiana Spahiu** – Kryetare, a mund të bëj një pyetje?

Lidhur me materialin që keni sjellë në komision, ku janë të pasqyruara të gjitha ndryshimet që do të bëhen, mund të na sqarojë dikush nëse janë ndryshime të dala nga studimi? Kush ka qenë kur është hartuar ky material?

A mund të na sqaroni, ju lutem, se këtu ndryshimet janë të gjitha se çfarë do të bëhen?

**Luljeta Krasta** – Paraprakisht është bërë një analizë e detajuar e legjislacionit shqiptar në këtë fushë nga profesoresha Arta Mandro. Nuk është ajo analiza, ndërkohë kemi diçka tjetër veç kësaj analize, që mund t'ua nisim me e-mail brenda ditës së sotme.

Ndërsa ato janë tabelat ku duhet të ndërhyhet.

*(Diskutim pa mikrofon)*

**Albana Vokshi** - Më falni!

Nuk mund të vish këtu e të thuash e ke shumë të qartë këtu! Ministria e Ekonomisë nuk ka sqaruar asgjë sot.

Unë e uroj zëvendësministren për beben, me jetë të gjatë e të lumtur!

Ndërkohë, ju si drejtores, duhet të kishit dhënë një raportim apo informacion më të detajuar dhe më të plotë.

Vini këtu, na jepni këtë tabelën, që madje nuk na i dhatë ju. por na i dha Ministria e Shëndetësisë, pa sqaruar. Ne këtë po kërkojmë, të na sqaroni se cilat janë hapat dhe ndryshimet në projektligj. Këtu keni ardhur për të na sqaruar, apo jo! Është non sens kjo mungesë papërgjegjshmërie nga ana juaj! Për më tepër, nuk ka pasur as koordinim midis ministrive dhe institucioneve përgjegjëse për zbatimin e konventës, sepse, nëse jeni të dyja institucione zbatuese të konventës, duhet të kishit ardhur, sipas edhe asaj që tha zonja Xhafaj, si bashkëpropozuese, sepse ata kanë të gjithë eksperiencën e duhur për vite të tëra për të dhënë informacionin, por edhe të mbështesin zbatimin e konventës apo të legjislacionit që mund të ndryshojë apo që do të vijë si paketë e kësaj konvente.

Gjithsesi, një përgjigje për Ilirin. Thatë 8 mars, por e ke pasur fjalën për 8 janarin, ku është ushtruar dhunë e paprecedentë ndaj grave falë paktit Rama-Basha. Kjo është ajo që duhet evidentuar, që nuk u pyet fare për gratë brenda apo jashtë. Policia ushtroi dhunë të paprecedentë, duke hedhur gaz lotsjellës e të tjera. Unë jam njëra prej atyre grave, që u bëra shumë keq nga gazi që hodhi policia, pavarësisht se isha një protestuese paqësore. Ka qenë policia...

**Klodiana Spahiu** – Ju i keni konfliktet brenda forcës politike. Kjo që jemi duke folur është një nga konventat më të rëndësishme dhe nuk duhet ndërhyrë me konfliktet që keni mes njëri-tjetrit. Nuk mundet kurrësi që të politizojmë një gjë të tillë.

**Albana Vokshi** - Të respektojmë njëra-tjetrën! Këtë çështje e ngriti kolegu yt. Më lejo t'i kthej përgjigje!

**Klodiana Spahiu** – Pse duhet ta sjellim këtu konfliktin që keni ju brenda partisë tuaj?

**Albana Vokshi** - A ka mundësi, Klodi? Më lejo ta mbaroj dhe pastaj ta jap unë fjalën! Mos më ndërprit! Rama – Basha janë bashkë dhe janë mirë. Mos ndërhy, se nuk e mbron dot ti!

**Klodiana Spahiu** – Konfliktin që keni brenda partisë, po ua them sërish...

Ne po ju respektojmë maksimalisht, por nuk duhet ta bëni sot, aq më tepër që kemi diskutimin e një konvente kaq të rëndësishme. Unë propozoj të vazhdojmë me konventën.

**Albana Vokshi** – Unë e di se ju vjen keq që ata të dy janë bashkë.

**Klodiana Spahiu** – A ka më keq se kaq! Ai thotë ti je me këtë, ai tjetri thotë ti je me atë. Mos i hapni këto tema, pra!

**Albana Vokshi** – Edhe ajo pjesë e paktit është, Ilir, se ky komision i takon opozitës, jo pozitës, që janë bërë bashkë tani, apo jo.

Ju lutem, unë dua ta falënderoj që e ngriti këtë shqetësim të dhunës së paprecedentë! Shpresoj shumë që organet të hetojnë mënyrën se si policia ka ushtruar dhunë me porosi dhe urdhër të Bashës në bashkëpunim me Ramën.

Kalojmë te konventa. Kishe një pyetje, apo jo?

**Ismet Beqiraj** – Singerisht, me këtë debat që u bë, edhe unë ndihem i dhunuar sot në vendin e punës. Ky është dhunim politik, do të thosha.

I bashkohem shqetësimit që doli nga pyetjet e kolegëve lidhur me relacionin. Edhe pse pak i vonuar ratifikimi i kësaj konvente për dhunën dhe ngacmimin, përsëri më mirë të shohim anën pozitive që po miratohet.

Thoni se po t’i kishim këto informacione më të plota edhe mbi bazën e studimit, do të bënim pyetje me këmbë në tokë, por tani mund të përsëritim edhe pyetjet që kanë bërë kolegët e tjerë.

Për shembull, unë kam një shqetësim, që është edhe shqetësim shoqëror, se thoni se procesi ka avantazhet e veta në relacion dhe deri tani vendi ynë ka bërë një përparim të konsiderueshëm. Shumë ligje janë në përputhje me standardet e BE-së të tilla si: Kodi i Punës, ligji “Për barazinë gjinore”, ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ligji “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”.

Kodi i Punës dhe ligji “për sigurinë dhe shëndetin në punë” kanë të bëjnë direkt me punëdhënësit dhe punëmarrësit, formalë apo informalë. Është parashikuar që të ndërhyhet te Kodi i Punës, sepse te përkufizimi i kësaj konvente termi “dhunë dhe ngacmime” ka parasysht edhe dëmin ekonomik, përveç psikologjik e të tjera, që i shkaktohet punëmarrësit në të gjitha llojet dhe format.

Te Kodi i Punës ligji thotë: “Ai që fiton me procedura ligjore e flak punonjësin a specialistin nga puna dhe nuk rikthehet në punë”. Nuk është si ligji për DAP-in, që “rikthehet në punë dhe i merr kokërr më kokërr”.

Nga ana tjetër, fenomeni për nxjerrjen e të dhënave personale lidhur me pagat, që unë e quaj si një krim, po evidentoj një gjë, që shumë kompani sigurojnë rrogën minimale të punonjësit, inxhinierit, specialisti e të tjerë. Edhe kjo është formë dhune dhe shkakton dëm ekonomik.

Ndërsa lidhur me ligjin “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, është e nevojshme të ndërhyhet, sidomos në sektorin e prodhimit formal dhe informal në industri, që të jenë të siguruar, t’u mbrohet shëndeti punonjësit/es, nuk po diskutoj ngacmimet e të tjera, gjë që lë



për të dëshiruar. E kam konkretisht për Inspektoratin e Punës. Ndaj duhet shoqëruar me një paketë të tërë, edhe pse thuhet se janë ligje të tilla, në përputhje me standardet e BE-së.

Lidhur me sigurinë dhe mbrojtjen në punë, unë që jam deputet me një eksperiencë të madhe dhe vij nga një sektor shumë i rëndësishëm i industrisë, e di shumë mirë se çdo të thotë siguria dhe mbrojtja e shëndetit në punë.

**Albana Vokshi** - Faleminderit!

Zoti Vasilli, fjala për ju.

**Petrit Vasili** – Mendoj se kjo konventë (nuk i hyjmë thelbit të saj, nuk jemi për të diskutuar vlerën e saj, pasi ajo është dakordësi ndërkombëtare, por për të shteruar të gjithë këtë debat dhe për të qenë më komodë edhe ne, edhe propozuesit) do të ishte e shpëtuar në rast ata që e kanë propozuar nuk do ta konsideronin thjesht dhe vetëm se kemi një konventë nga ato konventat për t'u paraqitur që miratohen. Kështu është trajtuar. Në rast se nuk do të donit ta trajtonit kështu, do të kishte seriozitet për të ikur nga këto konsideratat e përgjithshme.

Kjo konventë, për fat të mirë, ka një kollajllëk shumë të madh në fund, por, ose përtacia, ose superficialiteti nuk e kanë lejuar ta bëjnë siç duhet, se në fund fare ka rekomandimin se si konventa bëhet operative. Këtu ka kapituj me radhë se çfarë duhet të bëjë secili dhe mbi to automatikisht është i ndërtuar plani. Nuk ka nevojë për ndonjë akademizëm të madh, sepse hapat janë të përcaktuar, pasi kanë përdoruar ata akademizëm të madh. Në pjesën integrale të këtij dokumenti keni rekomandimin nr. 206, i cili përcakton të gjitha hapat dhe besoj që edhe kolegët janë dakord me mua, që ky është nga ato relacionet më rutinë që nuk thotë asgjë. I ka rënë sipër e sipër.

Po të kishte një minimum serioziteti, të gjithë këta njerëz që janë në punë e paguhen, do të bënin punën e tyre dhe do të thoshin: “Në bazë të rekomandimit nr. 206, ku jemi dhe ku duam të shkojmë”. Nuk është e thënë që duhen përmbushur të gjitha, absolutisht jo, dhe këtu ka mirëkuptim të plotë, ka punë që do të bëhen, ama, do të thoshte: “Lidhur me parimet themelore, këto 2, 3 apo 4 parime janë të reflektuara në legjislacionin tonë. Mbetet kjo dhe kjo”.

“Mbrojta dhe parandalimi”, është kapitulli II, ku janë të gjitha hapat siç duhet vepruar.

Shkojmë më tej: “Zbatimi, mjetet juridike dhe ndihma”. Të gjithë hapat janë të ndarë me pika. Duke e ditur që vendet kanë vështirësi edhe nga ana metodikore për të ndërtuar një plan veprimi, ata me shumë zgjuarsiri kanë përcaktuar të gjithë hapat. Këto janë ato që duhet të bëni. Vendos ato që ke bërë në raport me atë që thotë rekomandimi përkatës që kjo konventë të marrë jetë.

Vjen në komision dhe thua: “Lidhur me konventën jemi të gjithë dakord. E miratojmë”. Hapat e ndërmarrë deri tani janë 1, 2, 3, 4, 5. duke u bazuar mbi këtë rekomandim, se këtë konventë do të zbatohet dhe mbetet 1, 2, 3, 4, 5 të cilat disa janë të gatshme për t’u bërë, disa duan kohën e tyre e të tjera. Kështu, të gjithë do të ishim të qetë dhe do të thoshim se kjo konventë u bë dhe shteti e ka të qartë më pas se çdo të bëjë në të ardhmen. Ne si komision e si Kuvend do të thoshim se këtu e këtu na keni mbështetje ne, këtu do të duhet të bëni edhe konsultimet, sipas mendimit tonë, se nuk mund të pretendojmë se jemi absolutë për këtë gjë, dhe do të ishim interaktivë të dyja palët me njëra-tjetrën.

Pikat janë me radhë dhe një nga elementet thelbësore që u përmend me të drejtë është një nga kryefjalët këtu “dëmi fizik, psikosocial e të tjera”, ku një pozicion të pazëvendësueshëm ka Ministria e Shëndetësisë, e cila është partneri kryesor në përgatitjen e kësaj konvente.

Vetë kjo është një provë, që është një punë e përciptë. Këtu, gjithashtu, duhet pasur parasysh që, para se të vijmë te kjo konventë, ka pasur jo thjesht studime, por edhe konstatime të gjëra, të bëra dikur nga Avokati i Popullit, që në 2017-n. Ka pasur edhe studim për çështjet e dhunës morale, por edhe seksuale dhe në administratën publike, madje i mbështetur nga qeveria daneze, me një sërë rekomandimesh, ku flitej për ndryshimet në legjislacion dhe ndryshimet e buta në legjislacion, që quhen ndryshime në akte të tjera më të poshtme, deri në kodin e etikës së institucioneve përkatëse. Pra, ka pasur goxha punë.

Kjo konventë është shumë e rëndësishme dhe duhet të biem dakord, sepse ndërmjet fenomenit që shohim dhe fenomenit real ka një diferencë të madhe. Realisht, fenomeni është më i thellë, me problematikë të madhe, me kritikë, por është i pazëshëm. Për këtë arsye, po të shikoni mekanizmat këtu, të punëve të tjera të bëra nga organizmat joqeveritare, por edhe nga Avokati i Popullit, ka pasur shumë instrumente për ta bërë ta zëshëm, pra për të dhënë mundësi që fenomeni të denoncohet, por jo të mbrohet, sepse jetojmë në një realitet fiktiv, ku raportimet janë të pakta, mund të themi me gojën plot që nuk ka fare, ndërkohë që realiteti nuk është kështu. Ne duam ta përballojmë fenomenin realisht apo të bashkëjetojmë me një aparençë të një shoqërie të padhunuar, por që realisht është e dhunuar?

Të gjitha largimet arbitrare nga puna përbejnë një traumë të fortë psikosociale. Për një njeri që është larguar nga puna në mënyrë arbitrare, në një familje që mund të mbahet me një pagë, krijon një traumë të madhe edhe shoqërore, por edhe psikologjike, e cila mund të ketë edhe reflektime të forta shëndetësore. Ky është një element, përveç ngacmimeve të të gjitha formave, të cilat dihen.

Pra, e vërteta është që duket sikur kemi të bëjmë me një konventë mes shumë konventave që kalohen, por për peshën shoqërore që ka është shumë delikate. Sugjerimi miqësor është që t'i mbajmë parasysh të gjitha këto. Qeveria nuk e ka përgjegjësinë për zbatimin e saj; ne jemi këtu për ta mbështetur, për çdo hap që do të hedhë për ndryshimet, që do t'i duhen nga pikëpamja e legjislacionit. Të gjithë *road map*-in, rrugën dhe planin e ka në fund, në rekomandimin përkatës për zbatimin. Po të ecim pikë pas pike, sipas këtij rekomandimi, të gjithë jemi më mirë. Nuk është problemi që disa janë pro e disa janë kundër. Ne na lidh një interes i përbashkët, që kjo të ecë para, sepse të njohurit tanë, njerëzit tanë, personat me të cilët komunikojmë e të tjerë mund të jenë subjekte të kësaj dhune dhe, me sikletin që nuk e denoncojnë, e ndiejnë veten të pambrojtur dhe as ne e as ata nuk jemi mirë. Kështu që le t'i përmbahen kësaj gjëje dhe e kanë të zgjidhur çështjen. Edhe ne, në muajt që do të vijnë, mund të kërkojmë se cila është ecuria në lidhje me këtë konventë, hapat që janë hedhur dhe se çfarë mbështetjeje doni, që të ndihmojmë reciprokisht njëri-tjetrin. Kjo e bën edhe më serioze miratimin e kësaj konvente. Në parim, pa diskutim, shprehem pro miratimit të konventës.

**Albana Vokshi** – Faleminderit, zoti Vasili!

A kishit diçka për të shtuar?

**Olta Manjani** – Kam thjesht një ndërhyrje. E thashë në fjalën time që, në momentin kur konventa ratifikohet, ne e kemi të qartë *road map*-in, sepse është te studimi, i cili, për hir të së vërtetës, është me 100 faqe, dhe patjetër që, me aq kohë sa kemi në dispozicion, nuk mund t'i prekim të gjitha pikat. Pra, pas ratifikimit, sigurisht që ne e kemi të qartë *road map*-in, që është i përfshirë dhe në studim.

Patjetër që çështja është delikate, sepse ne thamë vërtet që nuk ka shifra të raportuara në Inspektoratin e Punës dhe, për shkak të delikatesës së çështjesh, është shumë e vështirë dhe ka drojë nga të ngacmuarit dhe të diskriminuarit që këto raste të raportohen drejtpërdrejt. Kjo lidhet edhe me humbjen e vendit të punës dhe të gjitha problemet sociale që lidhen me të, me turpin, që lidhet dhe me *stigma*-n e të qenit i ngacmuar apo i diskriminuar në vendin e punës.

Sigurisht që sondazhet dhe studimet janë më të lehta për t'u kryer, pasi janë anonime. Këtu theksoj edhe një herë rëndësinë e madhe që ka bashkëpunimi me donatorët, të cilët kryejnë studime dhe sondazhe të tilla, për të marrë një pasqyrë më të vërtetë dhe më reale të situatës. Kështu që ritheksoj edhe një herë rëndësinë e bashkëpunimit me këto institucione.

Faleminderit!

**Albana Vokshi** – Faleminderit, zonja zëvendësministre!

Sapo thatë diçka që nuk qëndron, që nuk keni kohë për të lexuar raportet, sepse janë 100 faqe. Për këto raporte shpenzohen para dhe duhet të lexohen, sepse prandaj prodhohen, së pari, për t'i lexuar ju, për t'i lexuar drejtoret që janë këtu me ju apo për t'i lexuar të gjithë nëpunësit dhe institucionet e agjencitë që do të merren me zbatimin. Prandaj hartohen raportet.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, të lutem! Kështu që të thuash që nuk kam kohë të lexoj raportin është...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Sapo e thatë, ose kemi kuptuar diçka krejt tjetër. Sapo thatë që është 100 faqe...

**Olta Manjani** - Jo, thashë që nuk premtom koha të diskutojmë 100-faqëshin në takimin e sotëm.

Gjithsesi, është faji ynë, le ta marrim përsipër, fakti që nuk e kishim vënë studimin të bashkëlidhur me dokumentet e tjera. Duke qenë se ne i referoheshim studimit qoftë në pjesën e relacionit, kemi menduar që në momentin kur do të duhet, do t'ju vendosim në dispozicion. Brenda ditës patjetër që do t'ju vendoset në dispozicion i gjithë studimi...

**Albana Vokshi** – Të lutem, edhe raportin e Këshillit Kombëtar të Punës!

**Olta Manjani** – Po, edhe ky raport do t'ju vihet në dispozicion brenda ditës.

**Albana Vokshi** – Faleminderit!

Zoti Vasili, a keni pyetje?

**Petrit Vasili** – Për të thënë të drejtën, pyetjen e kam shumë të thjeshtë dhe shumë praktike. Studimi është një instrument. Detyrimi është kjo marrëveshje dhe direktiva që ka në fund.

Tani, zonja zëvendësministre, konventa ka qenë shumë e qartë. Mbase ju, me të drejtë, mund të mos keni pasur gjithë kohën e duhur për t'u marrë me të, por kjo e ka zgjidhur problemin dhe nuk ka nevojë fare për studim. Kjo konventë ka rekomandimin përkatës për dhunën dhe ngacmimin me të gjithë hapat përkatës. Ky është edhe instrumenti me të cilin jetësohet kjo konventë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Me durim! Kini besim edhe tek eksperiencia e mëparshme administrative që kemi pasur.

Këtu është përcaktuar edhe metodika e hapave që do të hidhen, duke vënë hapat prioritarë, që janë parimet themelore, si dhe elemente të tjera të dorës së dytë. Që të jemi të gjithë të qetë me njëri-tjetrin që kjo ka marrë jetë, kjo metodikë, e pacaktuar nga ata, jo nga ne, ju lehtëson punën, se thoni që kjo nuk pret, duhet bërë e para dhe kjo mund të presë, pra

referojuni kësaj. Patjetër, studimi është i mirëpritur, sepse, sigurisht, është një ndihmë, por, në fund të fundit, kjo mbetet, sepse, edhe kur të vijë puna në takimet përkatëse që do të keni me ILO-n, dhe do të ndodhë që të keni një lloj raportimi ose informimi për këtë çështje, edhe ata kësaj metodike informimi do t'i qëndrojnë.

**Albana Vokshi** – Faleminderit!

**Olta Manjani** – Në fakt, studimi është kërkuar nga Ministria e Jashtme, por është shumë mirë që e kemi.

**Albana Vokshi** – Para se ta hedh në votim në parim projektligjin, a ka diskutime të tjera? Nuk ka.

Atëherë, e hedhim në votim projektligjin. Kush është dakord në parim me projektligjin “Për ratifikimin e konventës 190, “Konventa për dhunën dhe ngacmimin” të Organizatës Ndërkombëtare të Punës 1986”? Të gjithë janë pro. Nuk ka asnjë votë kundër dhe asnjë abstenim.

Neni 1. Kush është pro? Të gjithë janë pro. Nuk ka asnjë votë kundër dhe asnjë abstenim.

Neni 2. Kush është pro? Të gjithë janë pro. Nuk ka asnjë votë kundër dhe asnjë abstenim.

Votojmë në tërësi. Kush është pro? Të gjithë janë pro. Nuk ka asnjë votë kundër dhe asnjë abstenim.

Komisioni ynë është komision përgjegjës.

Ju lutem, do të mbledhim edhe rekomandimet e komisioneve të tjera, për t'ia dorëzuar më tej seancës! Do të diskutohet në seancë në datën 3 shkurt.

Faleminderit shumë!

Nëse nuk ka ndonjë gjë tjetër, e mbyllim mbledhjen për sot.

**MBYLLET MBLEDHJA**